



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.1.2025

Nr: 41

Ora: 10:00

VENDIM
PËR

CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE
SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve), për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 janë si më poshtë:
 - a) Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH), si partia kryesore e shumicës parlamentare, propozon 2 (dy) anëtarë;
 - b) Partia Socialdemokrate (PSD), si partia e dytë kryesore e shumicës parlamentare, propozon 1 (një) anëtar;
 - c) Partia Demokratike (PDSH), si partia kryesore e opozitës parlamentare, propozon 2 (dy) anëtarë;
 - ç) Partia e Lirisë (PL), si partia e dytë kryesore e opozitës parlamentare, propozon 1 (një) anëtar.
2. Bazuar në rezultatin e shortit për përcaktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë në përbërjen e KZAZ-ve:
 - a) Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH) do të propozojë anëtarin e shtatë për KZAZ-të e renditura me numër çift, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Partia Demokratike (PDSH) do të propozojë anëtarin e shtatë për KZAZ-të e renditura me numër tek, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
 - a) nga Partia Socialiste e Shqipërisë për ato KZAZ ku kjo parti propozon zëvendëskryetarin;
 - b) Nga Partia Demokratike për ato KZAZ ku kjo parti propozon zëvendëskryetarin.
4. Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve në KQZ nëpërmjet portalit të partive politike jo më vonë se data 01.02.2025.

Data: 28.1.2025 Nr: 41
Ora: 10:00



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI

